

Politika e privatësisë së Komercijalna Bankës AD Skopje

Kujdesi për klientët dhe privatësinë e tyre paraqet prioritet për Komercijalna bankën AD Skopje.

Kjo politikë i shpjegon llojet e informacioneve, të cilat mund t'i grumbullojmë dhe mbajmë gjatë vizitës së ueb faqes së Bankës, si dhe në çfarë mënyre përdoren ato informacione dhe me cilët palë ndahen ato. Po ashtu, përcakton mënyrën se si mund të na kontaktoni nëse keni pyetje ose jeni të brengosur për këto informacione.

Kjo Politikë është në pajtim me [Rregullat e mbrojtjes së të dhënave personale](#).

Informacionet që i grumbullon Banka gjatë vizitës së ueb faqes:

- Informacionet me të cilat ju identifikoheni gjatë shfrytëzimit të produkteve dhe shërbimeve të Bankës, përkatësisht të dhëna që ju vet na i dorëzoni dhe pajtoheni që t'i përpunojmë, si p.sh. përdorimi i Internet Bankës.
- Informacionet që nuk janë personale. Të dhënat për përmbajtjen, të cilën e shikoni dhe me të cilën punoni dhe që kanë të bëjnë me softuerin e kërkuesit të internetit, cilat përmbajtje i klikoni, cilat produkte dhe shërbime i vizitoni, lloji i kompjuterit si dhe informacione teknike të konektimit, që përdoruesi i shfrytëzon gjatë vizitës së ueb faqes, siç janë: sistemi operativ, dërguesi i shërbimeve të internetit dhe ngjashëm.
- Shërbimin, produktin ose regjistrimet nga serveri, të cilët përmbajnë informacione teknike lidhur me shfrytëzimin tuaj të shërbimit, produktit ose ueb faqes, sië janë IP adresa juaj, domeni, pajisja ose vendosja e aplikacionit, gabimet dhe aktivitetet e harduerit.
- Informacionet me vendndodhjen fizike të pajisjes suaj. Për shembull, kur e shfrytëzoni shërbimin e lokatorit të bankomatit më të afërt dhe jeni pajtuar për të kuptuar vendndodhjen tuaj.

Si i përdor Banka të dhënat e grumbulluara

Banka mund t'i shfrytëzoj informacionet, që i grumbullon për disa qëllime, edhe atë:

- T'ju siguroj shërbimin ose produktin e kërkuar, me ç'rast bënë edhe identifikimin tuaj;
- Të siguroj kujdesin ndaj klientit;
- T'ju pyes për mendim lidhur me produktet dhe shërbimet e Bankës dhe për zbatimin e anketave lidhur me produktet;
- T'i lehtësoj dhe përcjell kërkimet dhe kërkesat tuaja për informacione, kur lajmëroheni lidhur me Bankën dhe produktet e shërbimet;
- Të realizoj lojëra shpërblyese, gara dhe oferta tjera promovuese;
- Ta shqyrtoj mundësinë për punësimin tuaj nëse drejtoheni tek ne nëpërmjet ueb faqes dhe aplikoni për punësim në Bankë;
- Ndihmë gjatë reklamacionit ose problemeve gjatë shfrytëzimit të produkteve dhe shërbimeve.

Të dhënat e grumbulluara në mënyrë plotësuese shfrytëzohen për:

- Të krijohet statistikë grupore anonime për shfrytëzimin e ueb faqes tonë, produkteve, shërbimeve;
- Të përmirësohen produktet ekzistuese ose të krijohen produkte dhe shërbime të reja, rekomandime, reklama dhe komunikacione të tjera;
- Për përkrahje të klientëve në rast të problemeve gjatë shfrytëzimit të produkteve dhe shërbimeve.

Ndarja e informacioneve

Banka nuk i zbulon të dhënat tuaja personale për palët e treta pa pajtimin tuaj. Të dhënat personale mund të zbulohen vetëm në pajtim me ligjin.

Transferime ndërkombëtare të informacioneve tuaja

Në pajtim me rregulloret në fuqi dhe në bazë të udhëzimit/pajtimin tuaj gjatë shfrytëzimit të produkteve dhe shërbimeve të Bankës informacionet tuaja mund të transferohen në vende të tjera. (p.sh. gjatë realizimit të qarkullimit të pagesave në vendet e jashtme).

Komunikime reklamuese

Gjatë krijimit të raportit afarist me Bankën për shfrytëzimin e produkteve dhe shërbimeve, ju ofrohet mundësi të zgjidhni a dëshironi të pranoni njoftime të ndryshme dhe komunikata të tjera nëpërmjet postës, e-mailit, telefonit dhe/ose porosi me tekst (SMS) nga Banka. Këto komunikata mund të përmbajnë, për shembull, të dhëna për produktet dhe shërbimet më të fundit të Bankës.

Pranimin e materialeve reklamuese dhe njoftimeve nga Banka mund ta anuloni në çdo kohë, duke dorëzuar në sportelet e Bankës Deklaratë me shkrim.

Ju lutemi, kini parasysh së kohë pas kohe mund t'ju dërgojmë informacione të rëndësishme lidhur me produktet dhe shërbimet e Bankës, që i shfrytëzoni ose i keni shfrytëzuar. Këto njoftime nuk hyjnë në grupin e komunikatave reklamuese.

Çfarë bëjmë ne që t'i mbrojmë informacionet tuaja

Banka i merr të gjitha masat parapara teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale për pengimin e qasjes së paautorizuar dhe keqpërdorimit të tyre. Procedurat tona të sigurisë janë subjekt të kontrollit të vazhdueshëm dhe shprehje të arritjeve më të fundit teknologjike në këtë fushë.

Çfarë duhet të bëni që t'i mbronin informacionet tuaja

Si praktikë më e mirë e përgjithshme në internet ua rekomandojmë:

- Mos përdorni fjalëkalime të lehta (si fjalë nga fjalori);
- Mos përdorni fjalëkalim të njëjtë për më shumë llogari;

- Përdorni fjalëkalime të gjata (më së paku 8 shenja, po rekomandohen edhe me të gjatë);
- Përdorni fjalëkalime, të cilët përmbajnë kombinime me shkronja të vogla dhe të mëdha, numra dhe shenja të veçanta, p.sh. \$%^& etj..
- Ruani fjalëkalimet në vend të sigurt (asnjëherë mos i shkruani ose t'i ndani me të tjerët) dhe rregullisht ndryshoni ato.
- Ndiqni [rekomandimet e sigurisë](#) të dhëna nga Banka.

Qasje në informacionet dhe të drejtat tuaja

Nëse dëshironi të kuptoni se cilat kategori të të dhënave tuaja personale i përpunon Banka, për çfarë qëllimi dhe të kërkonti ndërprerjen ose ndalimin e përpunimit, ju lutemi drejtohuni në sportelet e Bankës.

Nëse dëshironi të bëni ndryshime, plotësime, fshirje ose azhurnim të të gjitha informacioneve të pasakta, po ashtu mund të drejtoheni në sportelet e Bankës ose këtë ta bëni nëpërmjet Internet Bankës, nëse jeni përdorues i të njëjtës.

Nëse mendoni se gjatë përpunimit të të dhënave nuk kemi vepruar në pajtim me të drejtat tuaja ligjore ose ligjet tjera në fuqi të privatësisë, mund të drejtoheni nëpërmjet sporteleve të Bankës deri te Zyrtarët për mbrojtje të të dhënave personale në Bankë.

“Cookies” dhe “web bugs”

Banka shfrytëzon teknologji të përhapura gjerësisht në industrinë e grumbullimit të informacioneve në lidhje me përdorimin e ueb faqes sonë dhe e-mail komunikimeve, të njohura si “cookies”(ëmbëlsira) dhe “web bugs”,. Për shembull, këto teknologji na zbulojnë se cilët klientë kanë klikuar në elementet e rëndësishme (në formën e linkut dhe grafikës) të ueb faqes ose porosive nëpërmjet e-mailit të Bankës dhe ta njohin kërkuesin gjatë vizitës së radhës në ueb faqen tonë. Shfrytëzimi i këtyre teknologjive bëhet enkas me qëllim të përmirësimit të përvojës së klientit dhe funksionalitetit të portalit të Bankës dhe faqes së Internet Bankës.

Pranimi i kushteve

Nëpërmjet përdorimit të kësaj ueb faqes pajtoheni, përkatësisht i pranoni dispozitat e Politikës së privatësisë së Komercijalna Bankës AD Shkup.

Nëse nuk pajtoheni me të njëjtën, ju lutemi shfrytëzojeni ueb faqen tonë.

Na kontaktoni

Nëse keni pyetje lidhur me Politikën e privatësisë së Komercijalna Bankës AD Skopje shfrytëzimit të ueb faqes tonë, ju lutemi na kontaktoni në:

Komercijalna Banka AD Skopje
Rr. Orce Nikolov, nr. 3

contact@kb.com.mk